REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Konferenca e Kryetarëve

VENDIM
Nr. 21, datë 29.06.2020

PËR VIJIMIN E ZHVILLIMIT TË MBLEDHJEVE NË DISTANCË NËPËRMJET MJETEVE TË KOMUNIKIMIT ELEKTRONIK TË KOMISIONEVE PARLAMENTARE DHE ZHVILLIMIN E MBLEDHJEVE TË KUVENDIT NË SEANCË PLENARE NË KUSHTET E DISTANCIMIT FIZIK

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 të Rregullores së Kuvendit, ligjit nr. 24/2020 "Për miratimin e aktit normativ nr. 3, datë 15.03.2020 "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19"" të ndryshuar"", pikës 4 të urdhërit nr. 351, datë 29.05.2020, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, "Për marrjen e masave të veçanta dhe kufizimeve për parandalimin e përhapjes së COVID-19", pikës 1 të urdhërit nr. 156/2 datë 11.03.2020, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për shpalljen e gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID 19", me propozim të Kryetarit të Kuvendit,

KONFERENCA E KRYETARËVE

VENDOSI:

I. Vijimin e zhvillimit të mbledhjeve në distancë nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik të komisioneve parlamentare deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

II. Vijimin e zhvillimit të mbledhjeve të Kuvendit në seancë plenare duke respektuar distancimin fizik të deputetëve dhe masat e tjera mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19 deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë.

III. Koha e diskutimeve për çështjet e parashikuara në seancë plenare është 180 minuta dhe ndahet në mënyrë përpjestimore ndërmjet grupeve parlamentare, sipas përfaqësimit të tyre në Kuvend.

IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për mbështetjen me burime njerëzore dhe logjistike të nevojshme për të siguruar vijimësinë e zhvillimit të mbledhjeve të komisioneve parlamentare me anë të mjeteve të komunikimit elektronik si dhe për marrjen e masave mbrojtëse të nevojshme për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19 në seancë plenare.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz RUÇI